



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA			
Njësi: Unit:	- KL -	Nr. Prot.: Prot. No.:	2549/23
Jediniça: Jediniça:		Br. Prot.: Br. Prot.:	
Nr. I faqeve: No. of pages:	- 5 -	Data: Date:	21/06/23
Br. stranica: Br. stranica:		Datum: Datum:	
Prishtinë/a		KEVP - KL	

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. I REF. 2549/2023

**KOMISIONI PËR LICENCIM I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS (OMK)**, në mbështetje të dispozitave të Nenit 9, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.3 dhe Nenit 35, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 17, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.3 dhe nenit 47, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.2 të Statutit të Odës së Mjekëve të Kosovës, si dhe Nenit 4 paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.3 të Rregullores për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e Mjekëve, Vendimit nr. ref. KO 42/2022 të Kuvendit të OMK, në mbledhjen e datës 21 qershor 2023, nxjerrë këtë:

VENDIM

- I. SHPALLEN TË PAVLEFSHME faksimilat me tituj Akademik/Shkencor sipas listës së këtij Vendimi, bazuar në Vendimin e Kuvendit të OMK KO 42/2022 për amendamentimin e akteve normative të OMK, respektivisht miratimin e plotësim-ndryshimit të Rregullores për Regjistrim, Licencim dhe Rilicencim për largimin e titujve Akademik/Shkencor nga faksimilat e lëshuara nga Oda e Mjekëve.
- II. NDALOHET përdorimi i faksimilave me tituj Akademik/Shkencor dhe çdo faksimil me përmbajtje të tillë konsiderohet i paautorizuar nga Oda e Mjekëve.
- III. Lista e mjekëve sipas këtij Vendimi përcillet te Prokurori i OMK për inicim të procedurës si shkak i mosrespektimit të akteve normative të brendshme të OMK.
- IV. OBLIGOHET shërbimi profesional i Odës të njoftoj Drejtorët e Institucioneve Shëndetësore të Mjekëve sipas listës së këtij Vendimi si dhe Inspektoratin Shëndetësor.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komisionit.

*Arsyetim*

Me datë 27 dhjetor 2022 Kuvendi i Odës së Mjekëve (tutje OMK) mban takimin e zakonshëm në të cilin shqyrtohen plotësim-ndryshimet e akteve normative të Odës së Mjekëve të Kosovës, përkatësisht plotësim-ndryshimi i Rregullores për Regjistrim, Licencim dhe Rilicencim në OMK. Ndër plotësimet-ndryshimet e kësaj Rregulloreje ishte edhe propozimi i largimit të titujve Akademik/Shkencor nga faksimilat e autorizuara nga OMK. Për këtë arsye, Kuvendi i OMK nxjerr Vendimin nr. ref. KO 42/2022 për miratimin e amandamenteve për plotësim dhe ndryshimin e Rregullores për Regjistrim, Licencim dhe Rilicencim.

Me datë 23 janar 2023 shërbimi profesional i OMK dërgon shkresë njoftuese dhe kërkon nga të gjithë mjekët të cilët kanë qenë të pajisur me faksimil me tituj Akademik/Shkencor, t'i dorëzojnë të njëjtit dhe të pajisen me faksimil ku si përmbajtje ka vetëm titullin specialistik. Në këtë njoftim të njëjtëve i'u është dhënë afat deri më 15 shkurt 2023 për dorëzimin e faksimilit me tituj si dhe është tërhequr vërejtje se pas datës së cekur çdo përdorim i faksimilit me tituj konsiderohet i paautorizuar nga OMK dhe paraqet shkelje të rregullave të brendshme të Odës.

Si rrjedhojë, afati i lartëcekur nuk është respektuar nga një pjesë e mjekëve dhe shërbimi profesional dërgon edhe një njoftim të rradhës me datë 10 mars 2023 për t'u dhënë afat të ri deri më 15 mars 2023 për të gjithë ata të cilët nuk kanë respektuar njoftimin paraprak.

Komisioni për Licencim me datë 21 qershor 2023 mban takimin e zakonshëm dhe shqyrton njoftimet e përcjellura të mjekët të cilët nuk kanë respektuar njoftimet dhe afatet për dorëzimin e faksimilave me tituj Akademik/Shkencor, me ç'rast konsideron se duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të OMK nr. ref. 42/2022 faksimilat me tituj Akademik/Shkencor duhet të shpallen të pavlefshëm. Njëkohësisht mosrespektimi i akteve normative të OMK, nga ana e Komisionit për Licencim konsiderohet shkelje e cila duhet të procedohet te Prokurori i Odës së Mjekëve si dhe të njoftohen Drejtorët e Institucioneve shëndetësore në të cilët punojnë mjekët sipas listës së këtij Vendimi dhe Inspektorati Shëndetësor.

Andaj, bazuar në Nenin 4 paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.3, Nenin 27, paragrafit 3 dhe 4 të Rregullores për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e Mjekëve, Vendimit nr. ref. KO 42/2022 të Kuvendit të OMK, Komisioni për Regjistrim, Licencim dhe Rilicencim në OMK vendosi si në dispozitivin e këtij Vendimi.

#### KOMISIONI PËR REGJISTRIM, LICENCIM DHE RILICENCIM - OMK

2549/2023 dt. 21.06.2023

**KËSHILLË JURIDIKE:** Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të iniciojnë procedurën e konfliktit administrativ në Gjykatën kompetente (*për çështje administrative*), në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi. Parashtrimi i padisë ndaj këtij vendimi nuk e pezullon ekzekutimin e tij.

Prishtinë, 21 qershor 2023

Kryetar i Komisionit për Regjistrim,  
Licencim dhe Rilicencim OMK

Dr. Shukrije Statovci, Mr. Sci.

*Sh. Statovci*

---

Ky vendim i dorëzohet:  
Kryetarit të OMK-së  
Mjekëve të listës në këtë Vendim  
Inspektoratit Shëndetësor  
Prokurorit të OMK  
Arkivit të OMK-së

